



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.262/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Faton Ademi kryesues, Adnan Kunushevci dhe Ferki Xhaferi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Lutfie M. Ajvazi, duke vendosur lidhur me ankesën e Partia Liberale Egjiptiane (PLE), me seli në Prishtinë, dega në Fushë Kosovë, paraqitur kundër Iniciativës së Re Demokratike (IRDK), me seli në Gjakovë, dega në Pejë, për shkak të thyerjes së heshtjes zgjedhore gjatë ditës së votimit, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen me datën 06 tetor 2019, në seancën e mbajtur me 06.10.2019, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet e pabazuar ankesa e subjektit politik Partia Liberale Egjiptiane (PLE), Anr.262/2019 e datës 05.10.2019, me të cilin ka kërkuar që subjektit politik Iniciativës së Re Demokratike (IRDK), t'i shqiptohet dënim me gjobë për shkak të thyerjes së heshtjes zgjedhore-postimit të fotografisë në rrjetin social facebook.

A r s y e t i m

Paraqitësi i ankesës Partia Liberale Egjiptiane (PLE), me datën 05.10.2019, ka paraqit ankesë në PZAP, me të cilën pretendohet se me datë 05.10.2019, gjatë ditës së heshtjes zgjedhore, Iniciativës së Re Demokratike (IRDK), ka vazhduar sponsorimin e fushatës zgjedhore në rrjetin social facebook, edhe në ditën e heshtjes zgjedhore. Më këtë rast pretendohet se është bërë thyerja e heshtjes zgjedhore, të përcaktuar me LZP. Me propozim për PZAP-in, që ankesa të miratohet e bazuar.

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të bazueshmerisë së ankesës dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore si dhe provave materiale-fotografisë së bashkangjitur, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenin 117 par.2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Nga shkresat e lëndës vërtetohet fakti se nga fotografia e postuar në llogarinë e kandidatit për deputet Afrim Kruezi, nga radhët e subjektit politik IRDK, në rrjetit social facebook, përmes të cilës është bërë fushat zgjedhore.

Prova e vetme e dorëzuar nga ankuesi që është një fotografi e postuar në llogarinë e kandidatit në fjalë në rrjetin social facebook, nuk ka datë të postimit (kur është postuar), pra nuk mund të identifikohet pretendimi i parashtruesit të ankesës se nga ana e subjektit politik

IRDK, është thyer heshtja zgjedhore përmes veprimit/ sponsorizimit të fushatës zgjedhore me anë të postimit të fotografisë në llogarinë e kandidatit të lartëcekur, në rrjetin social facebook, në mungesë të argumentimit të datës së postimit.

Paneli vlerëson se në bazë të fotografisë së prezentuar si provë materiale, e cila gjindet në shkresat e lëndës, nuk mund të konstatohet qartë dhe bindshëm siq përcaktohet me nenin 117 parag.3 të LZP-së, për të provuar se shkelësi i supozuar ka shkelur Kodin e Mirësjelljes, përmes thyerjes së heshtjes zgjedhore me datë: 05.10.2019, përmes të bërit fushatë në çfarëdo mënyre.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e konform nenit 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr.262 /2019 më datën 06.10.2019

Kryesuesi i Panelit

Faton Ademi



Këshillë Juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së,